



Në mbështetje të Ligjit Për Vetqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës nr.03/L-040, Ligjit Për Procedurën e Përgjithëshme Administrative nr.05/L-031, Ligjit Për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës dhe me propozim-vendim nga Drejtoria Për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të datës 04.09.2020 me nr.prot.434-25381, Kuvendi I Komunës së Klinës në mbledhjen e –VI- të rregullt për vitin 2020 të mbajtur me datë 25.09.2020 mori këtë

VENDIM

Përë

Për lirim të pjesëshëm të obliguesve të taksave për ushtrim të veprimtarisë, dhe qerave komunale, taksave për shfrytëzim të hapsirave publike, për periudhën e pandemisë.

- I -

Bizneset lirohen pjesërisht nga taksa ushtrimit të veprimtarisë për 25% për subjektet afariste që operojnë në Komunën e Klinës gjatë periudhës së pandemisë siq vijon:

Hotelet, auto shtëpit, Kompanit e Sigurimeve, minjerat, përfaqsit e ndermarrjeve të jashtme, Industria mekanike, metarlugjike dhe kimike, Motelet, Gurthyesit, depotë më shumicë, ndermarrjet publike dhe të mbeturinave, ujit, shpëdicionet, ndermarrjet prodhuese, resturantet, pishinat, pompat e karburanteve, Agjensit turistike, ndermarrjet projektuese, ndermarrjet botuese dhe grafike, ndermarrjet ndertimore, poliklinikat shëndetësore, ndermarrjet për servisimin e automjeteve, tregtia më pakicë e teknikes se bardh, mobileve, tregtia e sanitarisë, veprimtarit tjera të imta, autotransportuesit, taksistet, butiqet, argjentaret, mishëshitsit, autoshkollat, tregtija më pakicë e kpucve dhe artikujve tjer të lekurës, rrobaqepsit, sasllduesit, floktoret, internet-kafetë, videoklubet, radiot private, parkingjet, qebaptoret, çajtoreset, autolarjet, vep.e veterinës, bilsrdet, fotokopjet, kiosket, dyqanet në zonat rurale si dhe veprimtarit tjera të imta që nuk kanë qarkulluar gjatë pandemisë,

- II -

Fabrikat e përpunimit të miellit, Qëndrat tregtare, vetsherbimet, Furrat e bukës dhe barnatoret shëndetësore, KEK-u PTK, Bankat komerciale dhe njesit e tyre, nuk lirohen pasi që keto kanë zhvilluar veprimtarinë profesionale edhe gjatë pandemisë.

-III-

Qirat Komunale për lokale afariste dhe tregjet të ju zbritet qeraja komunale për 06(Gjasht) muaji, kurse obliguesit që shfrytëzojnë hapsirat publike komunale po ashtu u zbritet për 06 (gjasht) muaj.

-IV-

Arsyeshmeria e nxerrjes së këtij vendimi qëndron në faktin se gjatë periudhës së pandemis keto veprimtari nuk kanë punuar për periudhën e lartëcekur, vendimi vlenë vetëm për vitin 2020.

-V-

Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas protokollimit në MPL.

-VI-

Me këtë vendim njoftohen : MPL, Kryetari i Komunës ,Drejtorja e FEZH, Zyra për Informim, Shërbimi për punë të Kuvendit, një kopje për Arkivin e Komunës.

Vendimi është i plotfuqishëm me miratimin nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas protokollimit në MPL.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-28267/2020
Klinë, 01.10/2020



KRYESUESI
Edil GASHI